

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E FUSHË -KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË, KOSOVO POLJE

Ekstrakti nga procesverbali nga mbledhja e parë - I, e Kuvendit të Komunës, e mbajtur me datën 30.01.2025, ora 10:00h, në Sallën e Kuvendit të Komunës.

Prezentë në mbledhje ishin anëtarët e Kuvendit të Komunës: Ali Ismaili - Kryesues i Kuvendit të Komunës, Bashkim Krasniqi - Zëvendës Kryesues i Kuvendit të Komunës për Komunitete. Miranda Shabani, Jetmir Berisha, Vjollca Konjusha, Krenar Dumani, Jahush Krasniqi, Fisnik Sllamniku, Etnik Berjani, Fidan Berisha, Durim Hajra, Hasime Kostanica, Habib Mekolli, Vlonjat Hasani, Mirsad Qyqalla, Aida Alimi, Dardane Sogojeva Shala, Qëndresa Ademi, Artan Asllani, Arbnore Kelmendi, Hasan Ismajli dhe Radoman Doderovic.

Mungojnë: Laureat Gojnovci, Mirlinda Krasniqi, Shpend Bardiqi, Doruntina Jashari dhe Migjen Kolshi.

Kryetari i Komunës dhe Drejtorët e Drejtorive të Komunës: Amir Bullatovci - Drejtor për Administratë, Bardhyl Kojçiçi - Drejtor për Infrastrukturë, Ardit Sekiraça - Drejtor për Shërbime Publike dhe Mjedis, Ilir Hasani - Drejtor për Gjeodezi Kadastër e Pronë, Vjosa Kida Hyseni - Drejtorë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës përshëndeti të pranishmit në mbledhje, pas verifikimit të prezencës së anëtarëve të Kuvendit të Komunës, konstatoi se ekziston kuorumi për mbajtjen e mbledhjes dhe prezantoi këtë:

RENDITE

1. Aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhjet e Kuvendit të Komunës e datës 23.12.2024.
2. Raporti i punës për funksionimin e Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2024.
3. Propozim për shqyrtimin e parë të Projekt-Planit Vjetor të Punës së Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2025.
4. Propozim për ndryshimin e vendimit Nr. 88, të datës 25.06.2024 për anëtarët e Komisionit për rekrutimin e Drejtorëve dhe Zëvendës Drejtorëve në institucionet arsimore të Komunës së Fushë-Kosovës.
5. Shqyrtimi i Kërkesës Nr. 2028-2/24, të datës 13.12.2024, për rishqyrtimin e vendimit Nr. 146, të datës 03.12.2024, për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Xhamisë në Fushë-Kosovë.
6. Shqyrtimi i Kërkesës Nr. 3385-1/25, të datës 06.01.2025, për rishqyrtimin e vendimit Nr. 139, të datës 03.12.2024, për lejimin e mjeteve financiare për mësimin joformal.
7. Pyetje dhe përgjigje parlamentare.
8. Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Përshëndeti të pranishmit në mbledhje. Lexoi pikat e rendit të ditës për shqyrtim në mbledhjen e sotme.

Durim Hajra: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit në mbledhje. Ne nuk jemi dakord, me ndryshimet e rendit të ditës, që po imponohen nga Kryetari i Komunës, i cili po ndërhyn në punën tonë, edhe pse votë nuk merr pjesë në mbledhjet e Kuvendit të Komunës, por shpesh shpesh e ndryshon rendin e ditës dhe ju i nderuari Kryesues i Kuvendit të Komunës, në këtë mënyrë pa konsultim me ne, po e provokoni situatën e caktuar, duke e përjashtuar opozitën nga punimet bazike të punës, për të cilat ne jemi dakorduar paraprakisht.

Hasan Ismajli: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit në mbledhje, i nderuari Kryesues i Kuvendit të Komunës, unë e kam një vërejtje në faqen dy të ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar, ku kam diskutuar lidhur me zhvendosjen e pikës 'Pyetje dhe përgjigje parlamentare' nga pika e dytë e rendit të ditës, në fund të rendit të ditës, kjo është bërë pa pëlqimin tonë, me kërkesën e Kryetarit të Komunës, i cili nga zyra e tij dhe sipas vullnetit të tij, e ndryshon rendin e ditës, duke e shkelur dakordimin tonë, të cilin e dinë mirë edhe ju këtë i nderuari Kryesues i Kuvendit të Komunës, andaj nuk duhet ta pranoni, pavarësisht kërkesave të Kryetarit të Komunës. Qëndrimi jonë do të ndryshon shumë tani e tutje, duke vendosur në pah shkeljet që po bëhen, andaj ne nga tani e deri në muajin shtator, kur edhe e kemi fushatën për zgjedhjet lokale, do ta paraqesim për secilën çështje me rëndësi publike.

Mirsad Qyqalla: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit në mbledhje, tani ato që u thanë nga kolegët paraprakisht janë të ditura dhe ne nuk pajtohemi, me këtë mënyrë arbitrare të përpilimit të rendit të ditës, pa informimin tonë, duke shkelur parimet e dakordimit tonë, andaj ne sot do ta lirojmë sallën për këtë mbledhje.

Durim Hajra: Këtu nuk ka dilemë se ju Kryesues i Kuvendit të Komunës, duhet të jeni më i vendosur dhe të reflektoni, duke mos e vendosur në rendin e ditës interesin e shumicës, pra partisë në pushtet dhe duke shkelur jo një herë parimet e dakorduara nga ne.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Meqë pika 'Pyetje dhe përgjigje parlamentare', është pjesë e rendit të ditës dhe kemi edhe shumë çështje me rëndësi për diskutim, të cilat ne i njohim, unë nuk jam dakord me arsyetimet të cilat po i jepni dhe lëshimin e mbledhjes nga ana e anëtarëve të Kuvendit nga Partia Demokratike të Kosovës.

Jetmir Berisha: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit në mbledhje, ne jemi dakord me rendin e ditës, sepse edhe një pjesë e anëtarëve të Kuvendit të Komunës janë në fushat dhe atyre ju urojmë suksese në zgjedhje. Anëtarët tjerë të Lidhjes Demokratike të Kosovës jemi prezent në mbledhje dhe ekziston mundësia e mbarëvajtjen e punës së Kuvendit të Komunës.

Vlonjat Hasani: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit në mbledhje, këtu po shihet qartë tendenca e shumicës për lojën me vendosjen e pikës 'Pyetje dhe përgjigje parlamentare', në fund të rendit të ditës për t'i ikur transparencës dhe konstruktivitetit, qëllimi është që të na ndalet fjala brenda mbledhjes dhe diskutimet tona të shndërrohen në të pa rëndësishme, ne kemi shprehur edhe protestën tonë me diskutime përmbajtësore për zgjedhje dhe veprime, andaj ne e lëshojmë këtë mbledhje, sepse kjo punë kështu nuk është në rregull.

Pas sqarimeve tjera Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim për shqyrtim në mbledhjen e sotme rendin e ditës së propozuar.

U votua me: katërmëdhjetë vota 'për', asnjë votë 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej katërmëdhjetë anëtarë të pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se anëtarët e Kuvendit të Komunës me unanimitet të votave të anëtarëve të pranishëm në mbledhje e aprovuan për shqyrtim rendin e ditës së propozuar për mbledhjen e sotme.

Pika e parë (1) - Aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës e datës 23.12.2024.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi për aprovim ekstraktin e procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës e datës 23.12.2024, hap diskutimin për vërejtjet dhe sugjerimet tuaja.

Fisnik Sllamniku: Përsëritës të pranishmit në mbledhje. Unë dua të potencoi, se ekstrakti i procesverbalit e përmban vetëm përmbajtjen e diskutimeve, e jo të gjithë atë që ne e themi, sepse kjo punë është e rregulluar me rregullat për përgatitjen e një procesverbali, sepse ne po u jap më shumë hapësirë pyetjeve dhe përgjigjeve, se sa pikave me rëndësi më të madhe të rendit të ditës.

Hasan Ismajli: Kryesues i Kuvendit të Komunës unë nuk kam parë askund që Sekretari i Kuvendit të Komunës z. Hasan Gjyrevci të mban shënime për procesverbal, nuk ka mundur me mbërriri diçka sa i përket ekstraktit të procesverbalit, mua më nxiti kolegu im z. Fisnik Sllamniku, i cili tha procesverbali shkruhet në vija të trasha, ky procesverbal nuk është i një tubimi në rrugë, por është procesverbal i një Kuvendit të Komunës dhe sa mbërrin procesmbajtësi me shkruar, është diçka tjetër, sepse digitalizimi mungon dhe procesverbalin duhet me u shkruar me dorë, si në kohët e vjetra. Kishte qenë mirë që procesverbalet me i marrë ne me 'Cd kopje', sepse këto po incizohen. Unë nuk dal në foltoren e Kuvendit të Komunës, me fol në vija të trasha, unë çdo herë flas me detaje, për çështjet të cilat unë i ngriti, vetëm një shkronjë, nëse gabon në procesverbal i'a ndërron kuptimin, në faqe 21 tek procesverbali i kaluar, vetëm një shkronjë ka gabuar procesmbajtësi dhe i'a ka ndërruar komplet kuptimin, që unë kam dashtë me thënë. Unë nuk e akuzoj asnjëherë, sepse e di që nuk mundet me mbërriri, sepse është zyrtar ligjor dhe ne për ata duhet me i pas incizimet e mbledhjeve, sepse në të kaluarën na ka ndodhur me hy policia në sallën e Kuvendit, e që na u është thënë, që dikush nga ju ka dërguar mesazh, që Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, po kërcënon me armë për të votuar dhe nëse nuk është e shkruar dhe incizuar, atëherë Kryesuesi i Kuvendit të Komunës kishte pasur problem dhe kjo është arsyeja që procesverbali, duhet të shkruhet shkronjë për shkronjë.

Pas sqarimeve Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim për aprovim 'Ekstraktin e procesverbalit, me ndryshimin të cilin e dha anëtar i Kuvendit të Komunës z. Hasan Ismajli në faqen numër 21, nga mbledhja e Kuvendit të Komunës e mbajtur më datën 23.12.2024.

U votua me: katërmëdhjetë vota 'për', asnjë vota 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej katërmëdhjetë pjesëmarrës në votim.

Ne bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me unanimitet të votave të pjesëmarrësve në votim e aprovoi 'Ekstraktin e procesverbalit nga mbledhjet e Kuvendit të Komunës e mbajtur më datën 23.12.2024, me korrigjimin e diskutimit të anëtarit të Kuvendit të Komunës z. Hasan Ismajli në faqen numër 21.

Pika dytë (2) - Raporti i punës për funksionimin e Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2024.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Unë falënderoj Sekretarin e Kuvendit të Komunës z. Hasan Gjyrevci, për mënyrën e raportit të punës për funksionimin e Kuvendit të Komunës së Fushë-

Kosovës për vitin 2024, ku në materialin të cilin e keni të gjithë përpara, i keni të sqaruara në detaje, sa janë mbledhje të rregullta kemi pasur, sa të pashtëzakonshme dhe solemne, po ashtu në detaje i keni edhe mbledhjet e të gjitha komiteteve. Ku gjithsej kemi mbajtur 14 mbledhje në vitin e kaluar si Kuvend i Komunës. Po ashtu i keni edhe të gjitha vendimet, të cilat janë marrë, cilat janë kthyer, cilat janë shfuqizuar, cilat kanë mbetur në fuqi, shtat kanë mbetur tek pagesa e anëtarëve të komiteteve tjera, të cilët janë penalizuar për arsye të ligjit të pagave i cili ka hyrë në fuqi. Kjo ka shkaktuar një problem shumë të madh dhe për këtë arsye komitetet e tjera, nuk kemi mundur me i bërë funksionale këtë vitë, me përjashtim të Komitetit për Arsimit, Kulturë, Rinisë dhe Sport, i cili në mënyrë vullnetare ka punuar tërë vitin, edhe pse nuk janë paguar. Jemi në bashkëpunim me Nënkryetarin e Komunës, që t'u mundësojmë pagesën përmes mallrave dhe shërbimeve këtyre anëtarëve të komiteteve. Po ashtu sfidë ka qenë edhe tek pika 'Pyetje dhe përgjigje parlamentare', ku në këtë raport janë të detajuara të gjitha, edhe ndërprerja e mbledhjes, si rezultat i pakënaqësisë nga opozita tek pyetjet dhe përgjigjet. Unë ju premtoj se nëse në 'Plan të Punës së Kuvendit', e kemi si pikë të dytë, do t'i sjell në Kuvend në pikën e dytë të rendit të ditës.

Fisnik Sllamniku: Tek rendi i ditës, 'Raporti i punës për funksionimin e Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2024', në si Kuvend i Komunës kryesisht kemi funksionuar mirë, si sfidë kanë qenë funksionimi i komiteteve tjera, ku vlen të theksohet se Komiteti për Arsim Kulturë Rinë dhe Sport, ka qenë aktiv për kundër faktit që nuk janë paguar dhe unë mendoj, se këto komitete nuk mundën me qenë funksionale për deri sa nuk paguhën. Dua të ndalem tek pika 'Pyetje dhe përgjigje parlamentare', unë mendoj që po ju jepet shumë hapësirë kësaj çështje dhe kemi pasur probleme të ndryshme sa i përket kësaj çështje, se sa pikave tjera që janë shumë më të rëndësishme se kjo, të cilat po i kalojmë pa diskutime të mirëfillta, andaj kjo punë duhet të ndryshon.

Zëvendës Kryesuesi i Kuvendit të Komunës për Komunitete: Në mbledhjen e Komitetit për Komunitete, unë e kam theksuar se Kuvendi i Komunës së Fushë-Kosovës, është shembull për komunat tjera, të falënderojmë Kryesues i Kuvendit të Komunës për mënyrën e organizimit dhe mbajtjen e rendit. Po ashtu falënderojmë Kuvendin e Komunës së Fushë-Kosovës, ku e ka mbrojt një vendim i cili ka ardhur dy herë dhe ka dashur të politizohet me Nënkryetarin për Komunitete dhe nuk e kemi shfuqizuar, kjo është meritë e Kuvendit, sepse në këtë lëndë e kemi fituar edhe në gjykatë dhe këtë fal këtij Kuvendi.

Hasan Ismajli: Dua të ndërlidhem me kolegun z. Fisnik Sllamniku, ku tha se nuk është shumë e rëndësishme pika pyetje dhe përgjigje parlamentare, ndoshta për ju mundet me qenë më pak e rëndësishme ndërsa, personalisht për mua është shumë e rëndësishme, sepse unë në mbledhjen e kaluar i kam parashtruar pyetje drejtorit të arsimit, për çështjen e fëmiut tim, i cila ka marrë një grand, në shumën e mjeteve financiare prej 1,500.00€, me kryqin e kuq dhe unë kam kërkuar nga drejtori që ligji dhe rregullorja të obligon, me i pas tri komisione, komisionin përzgjedhës, kush përfiton grant, komisionin monitorues dhe nëse fëmiu im e ka keqpërdorë edhe ai duhet të shkoj atje ku kanë shkuar plotë të tjerë, unë dua përgjigje dhe drejtori sot nuk është hiq prezentë, unë zyrtarisht kam kërkuar për fëmiun tim. Komisioni monitorues i merr faturat dhe ata fatura duhet t'i sjellin dhe ju duhet me shkuar me ato fatura dhe me parë se ku është investuar.

Artan Asllani: Njëra prej sfidave të Komitetit për Komunitete, është që nuk po kemi përkthyes dhe po kemi shumë probleme.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Unë personalisht e kam bartë këtë sfidë edhe tek Drejtori i Administratës, sepse këtë çështje e kanë ngritur edhe të tjerët, mbetet çështje e tyre se, a do të na bëjnë zgjidhje.

Pika e tretë (3) - Propozim për shqyrtimin e parë të Projekt-Planit Vjetor të Punës së Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2025.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Sa i përket Projekt-Planit Vjetor të Punës së Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2025, mendoj se të gjithë debatin e kemi shterur, ideja është vetëm me realizuar. Nëse ka propozim shtesë ju lutem lajmëroni.

Pas sqarimeve Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim për aprovim 'Propozimin për shqyrtimin e parë të Projekt-Planit Vjetor të Punës së Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2025'.

U votua me: katërmëdhjetë vota 'për', asnjë vota 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej katërmëdhjetë pjesëmarrës në votim.

Ne bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me unanimitet të votave të pjesëmarrësve në votim e aprovoi për procedim në diskutim publik 'Propozim për shqyrtimin e parë të Projekt-Planit Vjetor të Punës së Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2025' dhe mori:

V E N D I M

1. Për aprovimin në parim për procedurën e diskutimit publik të 'Projekt-Planit Vjetor të Punës së Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2025'.
2. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është 'Projekt-Plani Vjetor i Punës së Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2025'.

Pika e katërt (4) - Propozim për ndryshimin e vendimit Nr. 88, të datës 25.06.2024 për anëtarët e Komisionit për rekrutimin e Drejtorëve dhe Zëvendës Drejtorëve në institucionet arsimore të Komunës së Fushë-Kosovës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Unë mendoj se edhe tek pika 'Propozim për ndryshimin e vendimit Nr. 88, të datës 25.06.2024 për anëtarët e Komisionit për rekrutimin e Drejtorëve dhe Zëvendës Drejtorëve në institucionet arsimore të Komunës së Fushë-Kosovës', debatin e kemi shterur në mbledhjen e kaluar, duhet me zëvendësuar për arsye të konfliktit të interesit, por s' kemi pasur vota në mbledhjen e kaluar.

Hasan Ismajli: Gjithçka është në rregull, ka ardhur herën e kaluar dhe nuk ka kaluar si shkak i mungesës së votave, sepse nuk mundesh me qenë në komision kur ke konflikt interesi, por unë kamë kërkuar, që i njëjti komision, me një konkurs tjetër, kryetari i komisionit drejtori i shkollës fillore në Lismir' e ka pasur një anëtare të familjes së tij dhe më kanë thënë që ligji e jep afërsinë dhe largësinë e konfliktit të interesit dhe ky konkurs tash duhet me u zëvendësuar me një person tjetër dhe konkursi tjetër jo, unë këtë nuk po e kuptoj, kam kërkuar sqarime, por nuk kamë marrë. Pas sqarimeve Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim për aprovim 'Propozim për ndryshimin e vendimit Nr. 88, të datës 25.06.2024 për anëtarët e Komisionit për rekrutimin e Drejtorëve dhe Zëvendës Drejtorëve në institucionet arsimore të Komunës së Fushë-Kosovës'.

U votua me: katërbëdhjetë vota 'për', vota 'kundër nuk ka' dhe asnjë abstencion, gjithsej katërbëdhjetë pjesëmarrës në votim.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me shumicë të votave e aprovoi 'Propozimin për ndryshimin e vendimit Nr. 88, të datës 25.06.2024 për anëtarët e Komisionit për rekrutimin e Drejtorëve dhe Zëvendës Drejtorëve në institucionet arsimore të Komunës së Fushë-Kosovës' dhe mori:

V E N D I M

Për ndryshim-plotësimin e paragrafit 1.4, nën paragrafit 1.4.3 të vendimit Nr. 88, të datës 25.06.2024, për zëvendësimin e anëtarit të Komisionit z. Nexhmedin Rexhepi - Zëvendës Drejtor i Shkollës Fillore të Mesme të Ulët 'Mihal Grameno' - Aneksi 2 në Fushë-Kosovës, për rekrutimin në institucionin parashkollorë 'Gëzimi Yni' në Fushë-Kosovës, me anëtarin e ri z. Salih Jashanica - Drejtor i Shkollës fillore të Mesme të Ulët 'Zejnel Salihu' në fshatin Bardh i Madh.

Pika e pestë (5) - Shqyrtimi i Kërkesës Nr. 2028-2/24, të datës 13.12.2024, për rishqyrtimin e vendimit Nr. 146, të datës 03.12.2024, për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Xhamisë në Fushë-Kosovë.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Unë dhe Nënkryetari i Komunës, kemi pasur tri takime me Ministrinë e Mjedisit dhe ende jemi duke i zhvilluar takimet, mirëpo për shkak të procedurave që ne i kemi, unë e kam sjellë në Kuvend shqyrtimin e Kërkesës Nr. 2028-2/24, të datës 13.12.2024, për rishqyrtimin e vendimit Nr. 146, të datës 03.12.2024, për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Xhamisë në Fushë-Kosovë, edhe pse mendoj se shumë shpejt kemi me pasur një përgjigje pozitive nga Ministria.

Hasan Ismajli: Nuk e kuptova, i nderuar Kryesues i Kuvendit të Komunës, a po e qetë me shfuqizuar apo çka, ai mori sqarime nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës. Kjo pikë ka ardhur dy herë, unë kam qenë njëri prej më të aktivë në diskutime lidhur me këtë punë, për sqaruar çështjen në fjalë, jo që unë kam qenë kundër xhamisë dhe kundër fesë, qysh më janë atribuar dhe fjalët kanë shkuar tek Bashkësia Islame e deri tek Myftiu z. Naim Tërnavë, që unë si asambleistë i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, kam qenë kundër ndërtimit të Xhamisë dhe kundër fesë, e cila nuk ka qenë e vërtetë aspak, unë kam prezantuar dokumentacion dhe e kam ngrit shqetësimin tim, ku kam thënë në mënyrën si ka ardhur kjo pikë, nuk kalon në asnjë ministri, sepse ka shkelje ligjore, nuk ka dokumentacion të kompletuar dhe e keni gabim mënyrën, se si e keni sjellë në Kuvendin e Komunës, unë e kam parë situatën në teren si po flitet, që unë kam qenë si fajtor, i nderuar Kryesues i Kuvendit, të gjitha ato që unë i kam prezantuar në Kuvend, me Hartë Zonale të Komunës, me fletë poseduese, me shkresa, me pronën e cila është e humbur, unë me tri faqe shkrim e kam njoftuar edhe Myftiun z. Naim Tërnavë, i cili të gjitha dokumentacionet i ka në zyrën e tij. Unë e di se dikush nga Ekzekutivi i Komunës, ka komunikuar dhe janë sqaruar dhe sqarimi ka qenë, ajo që unë e kam njoftuar. Tani a do ta shfuqizoni apo jo, është problem i juaji, sepse ju e keni fuqinë e votës, mirëpo nëse ky vendim nuk shfuqizohet, e ajo të cilën e thatë ju i nderuar Kryesues i Kuvendit, që keni mbet me biseduar, me Ministrin e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, unë nuk e di, sepse këtë vendim Ministria e Planifikimit e ka kthyer mbrapa, për herën e dytë, e herën e parë e ka kthyer Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, ju i nderuar

e kemi kryer detyrën e juaj, e kemi sjellë në Kuvend, nëse ky vendim, nuk shfuqizohet, i nderuari Zyrta i Ligjor i Kuvendit të Komunës, unë do ta pres afatin ligjor prej pesëmbëdhjetë ditëve, që ju ta bëni vendimin e plotëfuqishëm dhe nëse nuk e bon unë kam mbi ndjek hapat ligjor, sepse këtu që tri vite ka shumë vendime të cilat janë kthyer dhe nuk shfuqizohen dhe ju e dini pse nuk i bëni të plotëfuqishme, sepse janë të jashtëligjshme. Ju i kemi numrat mundësi me mbajt në fuqi, por ju jeni i obliguar me reaguari ose me njoftuar me shkresë Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal ose në afat pesëmbëdhjetë ditor, duhet me hedh në ueb-faqen zyrtare dhe vendimi të bëhet i plotëfuqishëm, sepse janë munduar me ma m'vesh që unë kam qenë kundër Xhamisë, të gjitha ekstraktet unë i'a kam dërguar myftiu edhe çka kam diskutuar unë dhe të tjerët.

Pas sqarimeve Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim për shfuqizim 'Shqyrtimi i Kërkesës Nr. 2028-2/24, të datës 13.12.2024, për rishqyrtimin e vendimit Nr. 146, të datës 03.12.2024, për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Xhamisë në Fushë-Kosovë'.

U votua me: asnjë votë 'për', asnjë votë 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej pesëmbëdhjetë anëtar të pranishëm në mbledhje.

Ne bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës nuk e shfuqizoi 'Kërkesën Nr. 2028-2/24, të datës 13.12.2024, pas rishqyrtimin e vendimit Nr. 146, të datës 03.12.2024, për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Xhamisë në Fushë-Kosovë'.

Pika e gjashtë (6) - Shqyrtimi i Kërkesës Nr. 3385-1/25, të datës 06.01.2025, për rishqyrtimin e vendimit Nr. 139, të datës 03.12.2024, për lejimin e mjeteve financiare për mësimin joformal.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi marrë një vendim për mësimin jo formal, ju e dini si shkon kjo pjesë, për arsye të një xhirollogarie, që nuk munden me hap shkollat, ne duhet me marrë një vendim, e të cilin e kemi marr dhe Ministria e ka kthyer pas një muaji e gjysmë me vonesë, këtu Ekzekutivi i Komunës e ka pritur afatin ligjor prej 30 ditëve, e ka vendos në fuqi, mirëpo unë si Kryesues i Kuvendit të Komunës, ju kam treguar se edhe nëse kthehet pas gjashtë muajve, unë e sjellë në Kuvend. Këtë vendim e kemi debatuar.

Hasan Ismajli: Unë mendoj se profa z. Jahush Krasniqi është kompetent sa i përket kësaj çështje, sepse jeni pjesë e tyre. Por nuk e di si ka ardhur ky vendim me u shfuqizuar, sepse unë nuk shoh shkelje ligjore në këtë vendim, sepse Ministria e Arsimit e lejon mësimin jo formal dhe të gjithë nxënësit të cilët ndjekin mësimin jo formal, me ligj janë të obliguar ta paguajnë një shumë të mjeteve financiare dhe me ato para duhet të paguhen mësimdhënësit, mirëpo gabimi është tek Ekzekutivit të Komunës, i cili nuk ka xhirollogari të veten, ky gabim është i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, sepse qysh në fillimi nuk ka shkuar ashtu siç duhet dhe nuk e ka paraparë se qysh mundem me i marrë këto para, por unë votoi kundër me u shfuqizuar ky vendim, sepse këta arsimtarë japin mund dhe parat janë të tyre.

Fisnik Sllamniku: Pa dyshim se ne e përkrahim mësimin jo formal, vetëm kisha pasur dëshirë nga Drejtoria e Buxhetit dhe Financave ta dinë, decentralizimi i shkollave është bërë që një kohë të gjatë, ne jemi të centralizuar, ku një shkollë nuk ka xhirollogari për mësimin jo formal, sepse nuk lejohet, dua ta di a'ka ndryshuar diçka me kohën apo vazhdon, që ende të mos lejohet hapja e

xhirollogarisë për mësimin jo formal, sepse ne këtë problem po e kemi çdo vitë. Pyes, pse nuk është e mundur kjo?

Pas sqarimeve Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e çli në votim për shfuqizim 'Shqyrtimin e Kërkesës Nr. 3385-1/25, të datës 06.01.2025, për rishqyrtimin e vendimit Nr. 139, të datës 03.12.2024, për lejin e mjeteve financiare për mësimin joformal'.

U votua me: asnjë votë 'për', asnjë votë 'kundër' dhe asnjë abstencion, gjithsej pesëmbëdhjetë anëtar të pranishëm në mbledhje.

Ne bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës nuk e shfuqizon 'Kërkesën Nr. 3385-1/25, të datës 06.01.2025, pas rishqyrtimit e vendimit Nr. 139, të datës 03.12.2024, për lejin e mjeteve financiare për mësimin joformal'.

Pika e shtatë (7) - Pyetje dhe përgjigje parlamentare

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Tani e kemi pikën 'Pyetje dhe përgjigje parlamentare', ftoi anëtarët e Kuvendit të Komunës që të parashtrojnë ndonjë pyetje nëse kanë.

Hasan Ismajli: Kryesues nga Drejtoria e Shëndetësisë nuk e kemi askënd prezentë, një ditë isha në Qendrën e Mjekësisë Familjare në Fushë Kosovë dhe pash një pacient, i cili nuk ishte banor i Komunës së Fushë-Kosovës dhe kontrollin u deshtë që ta paguaj në shumën e mjeteve prej 5€, po ashtu edhe një euro injeksionin, unë u ofrova në sportel dhe pyeta, vajzat të cilat ishin me projektin e Karitasit, më thanë se është urdhër i Ministrisë së Shëndetësisë, unë këtë pyetje dëshirova që të i'a parashtroj Drejtoreshës së Shëndetësisë, a është e vërtetë kjo që ka ardhur nga Ministria e Shëndetësisë apo ka ndodhur brenda, sepse mes Kuvendit kjo nuk ka shkuar. Po ashtu as Nënkryetari i Komunës nuk është prezentë, para dy mbledhjeve unë e kam ngrit një çështje, ku ju keni heshtur dhe këtë unë do të filloj që ta bëjë publike pas nëntë shkurtit, të gjitha parcelat e komunës, të cilat kanë dalur në prona private, jashtëligjshëm, pa vendim gjykatë, pa kontratë shitblerje dhe një nga to ka qenë këtu tek tregu, ku unë i'a kam lënë të gjitha dokumentet Nënkryetarit të Komunës dhe më ka premtuar që nga nesër, unë do të filloj të merrem me to, me Drejtorin e Inspektoratit, toka është shitur, serbi ka jetuar në Komunën e Fushë-Kosovës, ju ka kompensuar prona, e ka marrur tek tregu, ju ka dhënë këtu, ju kanë ndërtuar tri shtëpia, janë afër si ta kalon rrugën dhe vjen dikush i'a blen edhe ato tri shtëpia dhe thotë, ngadalë se e kam në letra, nuk është e regjistruar edhe pesë ari midis tregut dhe i shet, edhe ata pesë ari dhe unë para dy muajve kam reaguar pa u shitur ju keni heshtur. Unë rrezikoj sigurinë time, me ruajt prona komunale, sepse edhe mua më vinë disa mesazhe, ki kujdes mos fol. Për këtë arsye ne kërkojmë çdo herë me qenë 'pyetje dhe përgjigje' e dyta, sepse drejtoret në fillim të mbledhjes vijnë dhe ecin në kafe, me makina zyrtare dhe nuk i kontrollon askush, ndërsa zyrtari i cili tetë orë rrinë në punë, e sidomos punëtorët në sportel, nuk kanë kohë as bukë me ngrënë, ndërsa drejtorët prej taksave të qytetarëve, rrinë pesë minuta dhe ecin. Ne kemi toleruar që kredibilitetin tonë me ulë, me nënçmuar deri në atë masë, ku një drejtor i emëruar politikë, që sot është dhe nesër nuk është, me nënçmuar dhe me thënë unë shkoj kur të dua, unë jap përgjigje kur dua, unë si përgjigjem kush është ai, po këta asnjë nuk kanë guximin me hyrë në listën e kandidatëve, as për nivel qendror dhe as për nivel lokal, përveç atij zotriut atje, i cili ka qenë kandidat në zgjedhjet e kaluara dhe ka qenë më i votuari, se të gjithë të tjerët që i ka pasur Lidhja Demokratike e Kosovës, prej pas luftës. Brenda kësaj fushate, mbi tridhjetë punëtorë, janë punësuar me 'Projektin e Karitasit', duke filluar


nga këtu, shëndetësi, arsim, në shëndetësi sa do që të punësosh janë pak, sepse kanë shumë pacientë dhe japin shërbime për të gjithë ata që kanë nevojë, ndërsa këtu në Komunë tërë ditën rrinë në telefon dhe marrin rrogë prej taksave tona, parat që ne i kemi votuar në Kuvend për projektin e Karitasit dhe nuk bëjnë asgjë. Konkurs nuk ka pasur, janë marruar në nivel partiakë, ku Kryetari i Komunës e bënë listën, nuk shkon gjithë kështu duhet ta kemi një stop, ta luftojmë të keqen, vjen prej Prizrenit dhe punësohet në Fushë-Kosovë dhe fëmijët tonë, mbesin rrugëve, po ne kemi sakrifikuar në vitet e 90-ta në Fushë Kosovë, një bukë nëse kemi dalur me ble jemi rrahur e jemi nënçmuar, jemi ballafaquar nga mëngjesi, e në mbrëmje dhe sot fëmijët tonë, familjarët tonë nënçmohen dhe nuk mundën të punësohen, sepse vjen ajo nga Prizreni dhe e zënë vendin dhe thotë është psikologe klinike, me çfarë të drejte merr psikologe klinike, në çerdhe ose në shkollë, kur e kemi psikologjen e komunës sonë, cila e ka kryer fakultetin, masterin në të shtetit, e fshatit 'Lismir' dhe nuk merret në punë. Ju duhet që të thoni stop, merre të cilës dush parti po të jetë e Komunës së Fushë-Kosovës. Kjo nuk është në rregull aspak dhe këtë nuk duhet ta lejojmë, sepse e kemi barrën më të madhe, sepse po jetojmë këtu.

Pika e tetë (8) - Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Tani jemi në pikën 'Të ndryshme', ftoi të pranishmit nëse kanë ndonjë çështje për diskutim.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës falënderoi të pranishmit për pjesëmarrje në mbledhje. Mbledhja përfundoi në ora 11:10 minuta.

Procesmbajtës
Hasan Gjyrevci



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Ali Ismaili

